

Info

Epilepsia



Epilepsia dhe aftësia për vozitje

Lidhja e epilepsisë Hulumton – ndihmon – informon

UDHËZIM DHE ARSYETIM

Komisioni për trafik i Lidhjes zvicerane të epilepsisë u ka bërë një përmirësim të lehtë direktivave për aftësi vozitjeje për të fundit herë në vitin 2019.

Konsiderohet si e pranueshme që brenda një viti, nga 20.000 vozitës me epilepsi, njëri syresh të pësojë një fatkeqësi. Kjo ndodh atëherë kur vozitësi privat ka një probabilitet prej më së larti 40% të pësimit të një krize epileptike brenda një viti. Për shoferët sipas profesionit, rreziku nga kriza duhet të zbresë nën 2% brenda një viti. Pas krizës së parë mjekët mund të vendosin, kryesisht sipas secilit rast në veçanti, se sa gjatë dikush nuk do të guxojë të vozisë.

Ai ose ajo që pas një krize të parë nis të marrë medikamente, edhe nëse nuk është i/e sigurt se ka epilepsi, do të guxojë të vozisë sërish pas një kohe më të shkurtër. Nëse krizat shfaqen vetëm natën, tani do të guxojë të vozisë qysh pas dy vitesh (më parë 3 vjet).

Në planifikojmë aktualizime të reja sipas nevojës dhe shpresojmë në një bashkëpunim të ngushtë me vendet e tjera.

Komisioni për trafik i Lidhjes zvicerane të epilepsisë (Pierre Arnold, Claudio Bonetti, Günter Krämer, Johannes Mathis, Klaus Meyer, Stephan Rüegg, Margitta Seeck, Rolf Seeger, Daniela Wiest) udhëzimet i ka aktualizuar për herë të fundit në nëntor 2019.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Parakusht për një licencim fillestar ose rilicencim si drejtues automjetesh është një sqarim dhe vlerësim adekuat për rastin e veçantë, mundësisht të përsëritur periodikisht nga një specialist ose specialiste e neurologjisë FMH.
2. Pas një **krize fillestare epileptike aftësia për ngarje fillimisht është e pezulluar**. Kohëzgjatja e ndalesës së nevojshme për ngarje varet në secilin rast nga sqarimet dhe vlerësimet e nevojshme specialistike neurologjike.

Pas një **krize të hershme posttraumatike ose postoperative fillestare** (brenda një jave) si dhe një krize pa një **shkak të qartë provokues** (për shembull, sipas rregullit, një pagjumësi e pjesshme nuk është e mjaftueshme si shkak), pas një vlerësimi dhe sqarimi specialistik neurologjik, sipas rregullit, është e nevojshme **një ndalesë ngarjeje prej 3 muajsh**.

Pas një krize **fillestare të paprovokuar**, në bazë të një sqarimi dhe vlerësimi specialistik neurologjik, sipas rregullit, është e nevojshme **një ndalesë ngarjeje prej 6 muajsh**. Nëse pas një krize fillestare është konstatuar diagnoza e një epilepsie në bazë të rezultateve komplementare që justifikojnë kështu një rrezik të shtuar përsëritjeje në bazë të kriterëve ndërkombëtare të definimit të epilepsisë të vitit 2014, në këtë rast do të vlejnjë dispozitat përkatëse (shiko 3.; Ndalesë njëvjeçare për kategoritë e patentë shoferit B dhe B1, si dhe A dhe A1).

Te pacientët me një histori të **njohur shumëvjeçare të sëmundjes, dhe me një mungesë krize për së paku 3 vjet**, mundet që pas një sqarimi dhe vlerësimi specialistik neurologjik në një rast të izoluar, qartazi të provokuar, të një krize të përsëritur, mjafton një ndalesë ngarjeje prej 3 muajsh, ndërsa në rastin e një krize të përsëritur të paprovokuar, mjafton një pezullim ngarjeje prej 6 muajsh.

Nëse ndodh që pas një krize të parë të inicohet një trajtim medikamentoz, si një masë paraprake për pengimin e krizave të tjera, përkundër rezultatit përkatës të EEG dhe imazherisë, aftësia për vozitje mund të zbresë në tre muaj.

3. Në rastin e një epilepsie, **licencimi fillestar ose rilicencimi për shofer automjetesh**, sipas rregullit, mund të jepet nëse ekziston një **periudhë kohore pa kriza (me ose pa trajtim me antiepileptikë) për një vit** (për specifikat e kategorive të ndryshme të patentë-shoferëve shiko „Përcaktimet specifike“).

Një **shkurtim i këtij afati** është i mundur në rastet në vijim, përderisa të jenë siguruar të dhënat nga anamnezat mjekësore prej palësh të treta:

- së paku gjatë një viti, vetëm me kriza fokale të thjeshta, të përjetuara me vetëdije, pa paaftësi motorike, senzore ose kognitive gjatë ngarjes,
- së paku gjatë 2 vjetëve, vetëm me kriza të ndërlydhura me gjumin
- Epilepsi refleksesh të evitueshme përmes një stimulansi

Një **zgjatje e këtij afati** është e nevojshme në mes tjerash në rast të:

- abuzimit me alkool, medikamente ose narkotikë
- mungesës së përqendrimit, përkatësisht, të besueshmërisë
- krizash në rast të një lezionit/lëndimi progresiv ZNS

- të një çrregullimi metabolik, të pakontrollueshëm në masë të duhur
 - të një çrregullimi metabolik, të pakontrollueshëm në masë të duhur të një përgjumjeje/dremitjeje të tepruar gjatë ditës
- 4. Rezultatet e EEG duhet të jenë në harmoni me aftësinë për ngarje.**
- 5. Në rast të ndërprerjes së plotë të antiepileptikëve** gjatë kohës së ndërprerjes së medikamentit të fundit dhe në tre muajt e parë vijues nuk ekziston aftësia për ngarje. Përgjashtimet janë të mundshme në raste të justifikuara mirë (përgjithësisht më pak kriza, sindroma epileptike me rrezik të ulët përsëritjeje, reduktim i ngadalshëm i medikamenteve pas një periudhe së paku tre-vjeçare pa kriza). Nëse gjatë provës për ndërprerje vjen deri te shfaqja e përsëritur e një krize, pas rivendosjes së terapisë, pezullimi i nevojshëm i ngarjes do të jetë për 6 muaj. Një reduktim afati prej tre muajsh është i mundshëm në raste të justifikuara mirë.

Në rast ndryshimesh të tjera të medikacionit antiepileptik, si p.sh. zëvendësimi i farmakoterapisë nga një substancë aktive në tjetrën, ose nga një preparat origjinal në generika, gjykimi i aftësisë për ngarje i lihet në ngarkesë neurologut përgjegjës.

- 6. Detyrim-sqarimi mjekësor:** Mjeku trajtues përgjegjës është i detyruar që pacientin e prekur ta informojë proaktivisht lidhur me këto dispozita, dhe që t'ia shpjegojë vlerësimin e tij të saktë të aftësisë për ngarje në përputhje me rastin konkret individual. Sqarimi rezultues duhet të jetë i dokumentuar në dosjen e pacientit. Nuk ekziston një detyrim i përgjithshëm raportimi mjekësor, megjithatë ekziston e drejta ligjore e regjistrimit të pacientëve të pabindur (Ligji mbi Komunikacionin rrugor, neni 15d).
- 7. Detyrimi për paraqitje i pacientit:** në rastin e një krize, ndërprerja e menjëhershme e ngarjes dhe paraqitja tek neurologu përgjegjës, përkatësisht, tek neuropediatri.
- 8. Lëshimi i dëftesave fillestare dhe certifikatave** mbi aftësinë për ngarje pason në pajtim me udhëzimet e enteve kantonale të komunikacionit rrugor. Gjykimi i afateve kontrolluese realizohet nga neurologët.

PËRCAKTIME SPECIFIKE LIDHUR ME KATEGORI TË VEÇANTA TË PATENTË-SHOFERIT

1. Automjetet (makinat) e pasagjerëve (kat. B dhe B1) dhe motoçikletat (Kat. A dhe A1):

Licencimi fillestar ose rilicencimi sipas dispozitave të përgjithshme.

2. Kamioni (Kat. C dhe C1) dhe transporti profesional i udhëtarëve (BPT) dhe furgonët (mikrobusët) (Kat. D1):

Licencimi fillestar ose rilicencimi për kategoritë e patentë-shoferëve C dhe D1 është i mundur në rastin e një epilepsie në gjendje të manifestuar vetëm nëse ekziston një periudhë 5-vjeçare pa kriza dhe pa medikamente.

Në rastin e një krize të provokuar fillestare në kuadër të një sëmundjeje akute, të përkohshme, ose të trajtimit të saj, është i mjaftueshëm një pezullim ngarjeje prej 6 muajsh, në rast se rrethanat provokuese nuk ekzistojnë më.

Në rastin e një krize të paprovokuar fillestare duhet respektuar një afat pezullimi prej 2 vitesh. Përgjashtim: në rast se nën C1 automjeti është përdorur si automjet privat (në analogji me kat. B.) vlejnjë përcaktimet e kat. B.

3. Automjeti (me mbi 8 ulëse) / Autobusi (kat. D):

Nuk është i mundur licencimi fillestar ose rilicencimi për kat. D në rastin e një epilepsie të shfaqur një herë në gjendje të manifestuar (përgjashtim: sindromat epileptike feminare të shëruara). Pas një krize fillestare të provokuar ose të paprovokuar në moshën e rritur, një licencim është i mundur nëse ekziston një periudhë 5-vjeçare pa krizë dhe pa medikamente.

4. Automjetet me një shpejtësi maksimale deri në 45 km/h (kat. F.), automakinat bujqësore (kat. G), motoçikletat (Mofa) (kat. M) dhe automjetet tjera, që kanë nevojë për një dëftesë për Mofa (biçikleta të caktuara elektronike si dhe karrige elektrike me rrota/rollatorët elektrikë) si dhe borë-pastrueset/-hedhëset:

Licencimi fillestar ose rilicencimi do të pasojë në bazë të dispozitave të përgjithshme. Janë të mundshme përgjashtimet në raste të justifikueshme individuale (sidomos reduktimi ose afati i pezullimit).

5. Instruktorët dhe ekspertët:

Do të vlejnjë dispozitat e kategorive relevante për patentë shoferi.

6. Rastet e veçanta:

Drejtuesit e tramvajit, të lokomotivës, pilotët: pas një epilepsie të shfaqur një herë në gjendje të manifestuar ose pas një krize fillestare të provokuar ose të paprovokuar, drejtimi dhe aftësia për ngarje parimisht janë të pezulluara.

Në rastin e drejtuesve të makinave vetëngarkuese/shkarkuese, balonave, buldozerëve dhe autovinçave, motoskafeve, teleferikëve dhe vagonetave malore, vlerësimi i aftësisë drejtuese do të realizohet në bazë të dispozitave të përgjithshme.

Epilepsia mund të prekë këdo

Së paku pesë për qind e njerëzve gjatë jetës së tyre vuajnë nga një krizë epileptike. Afro një për qind e popullsisë sëmurët nga epilepsia gjatë jetës së tyre. Në Zvicër bëhet fjalë për 70.000-80.000 persona, midis tyre 15.000-20.000 fëmijë.

Lidhja e epilepsisë – shumëfish aktive

Lidhja zvicerane e epilepsisë hulumton, ndihmon dhe informon që nga viti 1931. Qëllimi i saj është përmirësimi i qëndrueshëm i përditshmërisë dhe gjendjes së të prekurve nga epilepsia në shoqërinë zvicerane.

Hulumtimi

Ajo nxit zhvillimin e mëtejshëm të shkencës në të gjitha fushat e epilepsisë.

Ndihma

Informacione dhe këshillime në gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht:

- për të prekurit dhe familjarët
- për specialistët e fushave nga më të ndryshmet

Informimi

Lidhja e epilepsisë informon dhe sensibilizon opinionin publik si dhe mbështet integrimin social të individëve të prekur nga epilepsia – si për shembull përmes kësaj broshure.

Komisioni për trafik i Lidhjes zvicerane të epilepsisë (Pierre Arnold, Claudio Bonetti, Günter Krämer, Johannes Mathis, Klaus Meyer, Stephan Rüegg, Margitta Seeck, Rolf Seeger, Daniela Wiest) udhëzimet i ka aktualizuar për herë të fundit në nëntor 2019.

Fletëpalosje të tjera në gjuhën shqipe:

Ç'është epilepsia?

Ndihma e parë në krizat epileptike

Informacione të tjera

Në gjermanisht, frëngjisht, anglisht, pjesërisht italisht:

Schweizerische Epilepsie-Liga (Lidhja zvicerane e epilepsisë)

Seefeldstrasse 84

CH-8008 Zürich

T +41 43 488 67 77

F +41 43 488 67 78

info@epi.ch

www.epi.ch

PC 80-5415-8

Fletëpalosja e aktualizuar herën e fundit: 12/2019

Realizuar përmes ndihmës miqësore të: Desitin Pharma GmbH, Eisai Pharma AG, Novartis Oncology, Sandoz Pharmaceuticals AG. Sponsorët nuk kanë ndikim në përmbajtje.